



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



## ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

**14 shkurt 2021**

### **Periudha e aplikimit/regjistrimit për votimi përmes postës 13 janar - 21 janar 2021**

Të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës me të drejtë vote që jetojnë jashtë vendit mund të aplikojnë për regjistrim për të votuar përmes postës.

Formularin për regjistrim për Votim Përmes Postës mund ta siguronit nga:

- [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org); te linku: “Shërbimet për Votuesit”, pastaj linku: “Votimi Përmes Postës”;
- Linja ndihmëse e Operacionit të votimit përmes postës  
+ 383 38 213 100  
+ 383 38 213 200; dhe
- Ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës.

Për ta fituar të drejtën e votimit përmes postës, ju duhet që:

- Të jeni nga mosha 18-vjeçare në ditën e votimit, më **14 shkurt 2021**;
- Të jeni shtetas i Republikës së Kosovës dhe të keni dokument të identifikimit të Republikës së Kosovës; dhe
- Të dëshmoni se keni të drejtë për t’u regjistruar në Regjistrin Civil të Republikës së Kosovës.

### **Aplikacionin e plotësuar mund ta dërgoni:**

- Përmes postës në adresë të KQZ-së, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Votimi Përmes Postës, Posta 6, Kutia Postare 351, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës;
- Përmes e-mailit zyrtar në njërin nga këta: [ovpp@kqz-ks.org](mailto:ovpp@kqz-ks.org); [ogpp@kqz-ks.org](mailto:ogpp@kqz-ks.org) dhe [vjk.kqz@kqz-ks.org](mailto:vjk.kqz@kqz-ks.org)
- Përmes faksit: + 383 38 213 200.

Aplikacionet për votim përmes postës duhet të arrijnë në KQZ deri më 21 janar 2021, deri në ora 18:00 sipas kohës lokale në Kosovë.

**Nëse ju aplikoni për t'u regjistruar përmes e-mailit, aplikacionin tuaj duhet ta dërgoni vetëm për vete apo rrethin e ngushtë familjar, përmes postës elektronike personale (e-mailit).**

**Nëse dërgoni aplikacione për persona të tjerë, aplikacionet për regjistrim do të refuzohen!**